

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ALSO ALBANIA” SHPK**

Ky statut dhe akt i themelimit, Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligji Nr. 9723 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**ALSO ALBANIA**” SHPK.

**KREU I**

*Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimitarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakut*

**NENI 1**

*Emri*

- 1.1** Shoqëria tregtare mban emrin “**ALSO ALBANIA**” SHPK.  
**1.2** Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

**NENI 2**

*Forma*

- 2.1** Shoqëria tregtare “**ALSO ALBANIA**” SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

*Zyra Qendrore*

- 3.1** Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**ALSO ALBANIA**” SHPK, e ka selinë në Shqipëri, Tiranë, Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pallati 68 - Hyrja 10 - Kati 4 - Banesa 15 1001. Numri i telefonit 0693116655 dhe adresa e dhe adresë emaili: [allioli.daniele@gmail.com](mailto:allioli.daniele@gmail.com)

**NENI 4**

*Objekti i Veprimitarisë*

- 4.1** Shoqëria ka për objekt veprimitaritë e mëposhtme:  
Zhvillimin, prodhimin, menaxhimin dhe tregtimin e montimit te dyerive, grilave, portave, dritareve dhe sistemeve te sigurise per klientet. Prodhimi i pajisjeve te brendshme, te jashtme dhe te sigurise. Zdrukthtari metali per perdorim civil dhe industrial. Tregtia me shumice dhe pakice, si ne formen tradicionale ashtu edhe ne ate elektronike, importin dhe eksportin, me automjete te veta dhe / ose te paleve te treta, perfaqesimin me ose pa depozite, te lendeve te para, produkteve te gatshme ose gjysme te gatshme; Materiale ndertimi: beton, pllaka, pajisje sanitare, materiale ndertimore, produkte gjysem te gatshme dhe jo te gatshme, pajisje,dritare, dyer, porta, Hag te vecante per ndertimet; Produkte per shtepite; Dru, lende drusore dhe produkte druri, te perpunuara, gjysem te gatshme dhe te parafabrikuara; Blerja, shitja dhe shkembimi i tokes se ndertimit, i ndertesave ne per gjithesi, i ndertesave qe do te restaurohen dhe rindertohen ose do te

shemben dhe rindertohen; Blerja, shitja dhe shkembimi i apartamenteve, dyqaneve dhe depove industriale; Kryerja e nderimeve ndertimet - civile, industriale, hekurudhore - riparime, rinovime, restaurime, te gjitha per llogari te shoqerise dhe / ose per individet private ose organeve publike; Menaxhimi i pasurive te patundshme ne pronesi dhe ne emer te paleve te treta; Qiradhenia (me perjashtim te qirase aktive) te pronave ne pronesi; Tregtia me shumice dhe pakice, si dhe import-eksporti i automjeteve, makinave, makinerive per industrine agro-ushqimore dhe te ndertimit. Shoqeria per arritjen e qellimit te objektit te saj social: Mund te marre, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj, interesa, kuota, aksione, perfshire aksione ne kompani te tjera, duke perfshire dhe tipe konzorciumi, ndermarrje te perbashketa joint venture), ne shoqatat e perkohshme te kompanive dhe konsorciumeve dhe ndermarrjeve me qellime te njejtë dhe / ose te ngjashme per qellime te investimeve te qendrueshme, dhe jo vendosja me kusht qe shkalla dhe objekti i pjesemarrjes te mos ndryshojne thelbesisht objektin e percaktuar ne statut; Mund te marre kredi dhe financime dhe ne per gjithesi te perdon gdo forme te financimit me institucionet e kreditit, bankat, kompanite ose individet, duke dhene letrat me vlere te pershtatshme dhe garancite e pasurive te patundshme, reale dhe personale.

### NENI 5 *Kohëzgjatja*

**5.1** Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "ALSO ALBANIA" SHPK do të jetë deri më 31 dhjetor 2091 dhe mund të zgjatet.

### NENI 6 *Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit*

**6.1** Shoqëria tregtare "ALSO ALBANIA" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**6.2** Mbledhja e Ortakeve, mund të vendosë, transferojë dhe/ose të mbyllë, si brenda edhe jashtë shtetit shqiptar, degë sekondare, filiale, seli, agjensi, zyra përfaqësimi dhe bashkësi lokale të çdo natyre.

### NENI 7 *Përgjegjësia e Ortakut*

**7.1** Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "ALSO ALBANIA" SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

### KREU II *Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit*

### NENI 8

#### *Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat*

**8.1** Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ALSO ALBANIA" SHPK është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

## **8.2 Ortakët e shoqërisë janë:**

- z. **Daniele Mauro Franco Allioli**, atësia Antonio Pierluigi lindur në SVIZZERA (CH) më 15.11.1965 **nënshtetas italian**, me numer dokumenti CA12980LN, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 5.000 (pesë mijë) lekë e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë;
- z. **Tatyana Alekseevna Solodova**, atësia Alekseei lindur në KUYBISHEV (RU) më 21.07.1982 **nënshtetas italian**, me numer dokumenti AV4026940, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 5.000 (pesë mijë) lekë e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë;  
Kapitali i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht nga ortakët e shoqërisë.

## **NENI 9**

### ***Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar***

**9.1** Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**9.2** Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

## **NENI 10**

### ***Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar***

**10.1** Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme.

**10.2** Kalimi i kuotës bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm ose edhe vetëm nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotës, pa qenë nevoja e marries së një vendimi paraprak nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

**10.3** Kuota mund të pjesëtohet për shkak të kalimit.

**10.4** Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme në rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### ***Organet e Shoqërisë, Punësimet në Shoqëri***

## **NENI 11**

### ***Asamblea e Përgjithshme***

**(Ortaku i Vetëm)**

**11.1** Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

## **NENI 12**

### ***Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm)***

**12.1** Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) merr vendime për shoqerinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- përcaktimin e shpërblimeve, për administratorët, likuiduesit dhe eksperitë kontabël të regjistruar;

- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotës;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- vendos për pagat e punonjësve dhe dhënien e shpërblimeve përkatëse;
- të gjitha çështjet e tjera të cilat parashikohen në ligji dhe nuk i janë deleguar Administratorit të Shoqërisë.

### **NENI 13**

#### ***Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku të Vetëm)***

**13.1** Për thirrjen dhe mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm) do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**13.2** Vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm, së bashku me procesverbalin e mbledhjes dhe aktet e tjera që i bashkëlidhen sipas ligjit këtij procesverbalit, regjistrohen në librin e shoqërisë.

### **NENI 14**

#### ***Administratori***

**14.1** Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

**14.2** Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**14.3** Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të shoqërisë. Ai ka të drejtë të:

- përfaqësojë shoqerinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët;
- të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë si dhe ti depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit, punësimin dhe pushimet nga puna të personelit;
- të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;

- të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- të kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

**14.4** Administratori i shoqërisë do të jetë Z. **ENDI SINANI**, atesia FERIT, lindur në Tirane Albania më 12.08.1992 me numër dokumenti J20812039E, me një afat 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

*Specimeni i nënshkrimit te administratorit:*

#### NENI 15

##### *Punësimet në shoqëri*

**15.1** Për punonjësit që do të punësohen në Shoqëri, marrëdhëni e punës midis Shoqërisë dhe këtyre punonjësve, do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

**15.2** Shoqëria merr përsipër të derdhë në kohën e duhur të gjitha detyrimet ligjore dhe për të punësuarit të bëjë sigurimin e tyre në organet kompetente duke derdhur edhe përqindjen e kontributave përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### KREU IV

##### *Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve*

#### NENI 16

##### *Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor*

**16.1** Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

**16.2** Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të regjistruar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

#### NENI 17

##### *Shpërndarja e Fitimeve*

**17.1** Ortaku i Vetëm ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

**17.2** Shoqëria mund të shpërndajë fitime vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

#### KREU V

##### *Riororganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë*

#### NENI 18

### *Riorganizimi i Shoqërisë*

**18.1** Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjeter, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

**18.2** Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm).

### NENI 19

#### *Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë*

**19.1** Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku të Vetëm).

Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtronhet procedurës së likuidimit.

**19.2** Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

### NENI 20

**20.1** Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare” (i ndryshuar), Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

*Ky Statut hartohet dhe nënshkuhet në 3 (tre) originale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një originale qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.*

### **ORTAKU I VETËM**

Tatyana Alekseevna Solodova

Daniele Mauro Franco Allioli

Tiranë 23.09.2022